



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Tepelenë, më 12.06.2026

DEKLARATË PUBLIKE

**E KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
“Për Përmirësimin e Transparencës”**

Në kuadër të angazhimit për forcimin e qeverisjes vendore, rritjen e besimit të publikut dhe garantimin e një administrimi sa më të hapur e të përgjegjshëm, Këshilli Bashkiak Tepelenë angazhohet publikisht për përmirësimin e transparencës institucionale dhe forcimin e komunikimit me qytetarët.

Për këtë qëllim, Këshilli Bashkiak do të ndërmarrë masa konkrete për publikimin në kohë të vendimeve dhe akteve të miratuara, rritjen e aksesit të qytetarëve në informacionin publik në përputhje me legjislacionin në fuqi, zhvillimin e konsultimeve publike për çështje me interes për komunitetin, përmirësimin e komunikimit institucional me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, si dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit për garantimin e llogaridhënies.

Gjithashtu, Këshilli Bashkiak po përdor platformat elektronike dhe mjetet dixhitale për informimin e publikut, duke mundësuar një komunikim më të shpejtë, më të hapur dhe më transparent me qytetarët, si dhe do të punohet për rritjen e standardeve të integritetit institucional, etikës administrative dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Këshilli Bashkiak Tepelenë mbetet i angazhuar për garantimin e një qeverisjeje vendore transparente, gjithëpërfshirëse dhe në shërbim të interesit publik.

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

